



# UNIVERSITETI I SHKODRËS

## “Luigj Gurakuqi”

### SENATI

Nr. 3594 prot.

Shkodër, më 13. 11. 2015

### V E N D I M 465

Në mbështetje të ligjit nr. 80, datë 22. 07. 2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimit shkencor në institucionit e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”(i ndryshuar), Ligji nr. 44/2015 datë.30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Ligjit nr.9131 datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, Statutit të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” neni 40, Kodit të Etikës së U.SH-së neni 8 e vijues, në mbledhjen e tij të datës 13.11.2015, senati pas shqyrtimit të relacionit të Fakultetit të Drejtësisë,

#### Vëren:

Duke marrë shkas nga emisioni investigativ “Fiks Fare” i televizionit kombëtar “Top Channel” në datat 13 dhe 14 tetor 2015, me urdhërin 393, dt. 15. 10. 2015 të Rektorit të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” është vendosur pezullimi nga ushtrimi i detyrës për pedagogun e Fakultetit të Drejtësisë z. Fran Qafa dhe është iniciuar procedura e mëtejshme për masë disiplinore në Këshillin e Etikës. Me vendimin nr. 401, dt. 16. 10. 2015 të Senatit të USH-së është vendosur lënia në fuqi e pezullimit nga detyra e vendosur nga Rektori me urdhërin 393, dt. 15. 10. 2015, si dhe i është kërkuar Fakultetit të Drejtësisë për të paraqitur një relacion me shkrim për pedagogun në fjalë ku të evidentohen shkeljet e mundshme të këtij pedagogu. Me vendimin nr.395 dt.16.10.2015, Këshilli i Etikës i Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” ka vendosur masën disiplinore të largimit nga detyra për pedagogun e Fakultetit të Drejtësisë z.Fran Qafa. Në mbështetje të Statutit të USH-së, neni 40, ky vendim duhet të miratohet në mënyrë përfundimtare nga Senati i USH. Me shkresën nr.3364 dt.30.10.2015, në respektim të procedurës të parashikuar në Kodin e Etikës, pedagogut në fjalë i është njoftuar vendimi i Këshillit të Etikës dhe e drejta për tu dëgjuar para Senatit për pretendimet e tij në mbledhjen e datës 13.11.2015. Konstatohet se gjatë gjithë kësaj periudhe pedagogut në fjalë i janë njoftuar të gjitha procedurat dhe vendimet përkatëse, por ai nuk është paraqitur në vendin e punës dhe nuk ka paraqitur asnjë arsye që të justifikojë mos praninë e tij, gjithashtu konstatohet se edhe pas njoftimit me shkrim në vendbanimin e tij ai nuk është paraqitur fizikisht në këtë mbledhje të Senatit dhe as nuk ka paraqitur ndonjë pretendim me shkresë për procedurën e masës disiplinore. Në këto kushte Senati vijoi mbledhjen dhe shqyrtoi informacionin e Fakultetit të Drejtësisë dhe vendimin e Këshillit të Etikës për shkeljet e pretenduara për pedagogun në fjalë nga ku rezulton se:



Pedagogu Fran Qafa ka shkelje të përsëritura në ushtrim të detyrës, gje e cila provohet edhe nga dhënia e masës disiplinore "Vërejtje" me vendimin e Rektorit nr. 116 të datës 23. 04. 2014. Gjithashtu, ky pedagog nuk është paraqitur në punë pa arsye në datat 13 deri me 16 tetor 2015 dhe ka mungesa të vazhdueshme në procesin mësimor dhe braktisje në pjesëmarrjen në komisione dhe në detyrat e tjera të ngarkuara nga fakulteti (shih informacionin e FD).

Ndërsa sa i takon videos të bërë publike në emisionin investigativ "Fiks Fare" të televizionit kombëtar "Top Channel" në datat 13 dhe 14 tetor 2015, ku ky pedagog paraqitet duke kryer veprime korruptive, nga Fakulteti i Drejtësisë është konfirmuar se në videon e paraqitur në emisionin "Fiks Fare" bëhet fjale për një riprovim të datës 24. 01. 2015, i cili ka qenë detyrë e komisionit të zhvillohet në orën 11.00, ndërsa në orën 14.00 nuk ka patur të parashikuar turn tjetër për të zhvilluar këtë provim dhe anëtari i dytë i komisionit nuk ka qenë i pranishëm.

Përsa më sipër, Senati me votim të fshehtë,

**V e n d o s i :**

1. Dhënien e masës disiplinore të largimit nga detyra dhe zgjidhjen e menjëherëshme të kontratës së punës për pedagogun e Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" z.Fran Qafa, për shkaqe të justifikuara që lidhen me shkeljen e rëndë të detyrimeve kontraktuale dhe të etikës profesionale të përshkruara më sipër në ushtrim të detyrës.
2. Ngarkohen Fakulteti i Drejtësisë, Kancelari, Dega e Kurrikulave, Standarteve dhe Kërkimit Shkencor, Dega e Burimeve Njerëzore dhe Dega e Financës për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Sekretari i Senatit**

*Fatmir Vadohej*  
**Prof. as. dr. Fatmir Vadohej**

**Kryetari i Senatit**

*Artan Haxhi*  
**Prof. dr. Artan Haxhi**

